



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE E MITROVICËS
OSNOVNI SUD MITROVICA – BASIC COURT OF MITROVICA

C.nr.668/2015

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, (e vendosur në objektin e degës së kësaj gjykate në Vushtrri) departamenti i përgjithshëm, si kontestimore e përberë nga gjyqtari individual Naim Mehulli, ne çështjen juridike të paditësit:

(), Prishtinë, të cilën e përfaqëson nga Mitrovica, për sipas autorizimit me shkrim kundër të paditurit: nga Mitrovica, për rimbursim të dëmit, pas mbajtjes së seancës kryesore me datë: 27.09.2017 bie këtë:

A K T G J Y K I M

1. **OBLIGOHET** i padituri që brenda afatit 15 ditor t'ia paguajë paditëses në emër të rimbursimit të dëmit shumën prej 859.00 euro me kamatë sikurse për mjetet e deponuara bankare pa destinim të caktuar, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm,
2. **OBLIGOHET** paditësi që në emër të shpenzimeve gjyqësore për përpilimin e aktgjykimit t'ia paguaj gjykatës shumën prej 15 euro në afat 15 ditor të gjitha këto nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësja ka ngritur padi me datën 01.12.2015 me anë të së cilës ka kërkuar që në emër të rimbursimit të dëmit i padituri t'ia kompensoi shumën prej 859.00 euro të shkaktuar në aksident trafiku me datë 04.08.2012.

E autorizuar e paditëses në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 19.09.2017 dhe në fjalën përfundimtare deklaroi se mbetet në tërësi sipas padisë dhe kërkesëpadisë i propozoj gjykatës që të bene administrimin e provave dhe në rast të marrjes së aktgjykimit të merr për baze padinë dhe provat e prezantuara në këtë kontest.

I padituri në seancën e shqyrtimit kryesor mungoj, ku gjykata e ka ftuar në mënyrë të rregullt ndërsa mungesën nuk e ka arsyetuar.

Gjykata ne shqyrtimin kryesor i administroi këto prova: pasqyra e transferit e dt.14.09.2012, vendimi i paditëses nr.1325/12 dt.04.09.2012 për urdhër transfer, vendimi i komisionit te shkalles se dyte dt.28.08.2012, vendimi me numër te dosjes FK-1172/2012 dt.28.08.2012, ujdia jashtë gjyqësore nr. dt.03.09.2012, procesverbali mbi vlerësimin e demit ne automjet nr.1172/12 dt.08.08.2012, ankesa e palës dt.27.08.2012, oferta e dt.08.08.2012, raporti i Policisë dt.04.08.2012, libreza e automjetit për personin e tret, paraqitja e demit nga pala e tret dt.08.08.2012, aktvlersimi i demit nr.1172/12 dt.28.08.2012, vendimi i shkalles se par për trajtimin e dëmeve dt.15.08.2012.

Pas analizimit dhe çmuarjes se provave te cekura një nga një dhe te gjitha se bashku si dhe rezultatit te krejt procedurës , ashtu siç është përcaktuar me nenin 8 të LPK, gjykata vlerësoi se ne mes te palëve procedurale nuk janë kontestuese këto fakte:

Për gjykatën nuk është kontestues fakti se i padituri ka qenë pjesëmarrës dhe shkaktar i aksidentit të datës: 04.08.2012 me automjetin " " me nr. te targave " " i cili ka qen i pa siguruar gjegjësisht sigurimi i ka s'kaduar në momentin e aksidentit, në të cilin aksident i padituri e ka goditur automjetin me targa " " , pronë e z. " " nga " " duke i shkaktuar dëme materiale, kjo vërtetohet me raportin e aksidentit me nr. 2012- " " i dt. 04.08.2012, si dhe skica e aksidentit .

Për gjykatën nuk është kontestues fakti se personi i tretë, i dëmtuar ka parashtruar pranë paditëses kërkesën për kompensim të demit me dt.08.08.2012.

Nuk është kontestues fakti se paditësi ka lidh ujdj jashtëgjyqësore me dt.03.09.2012, me të dëmtuarin " " për kompensimin e demit në shumën prej 859.00 euro.

Raporti i policisë i datës 04.08.2012 vërteton faktin se automjeti i të paditurit ka qen i pa siguruar ne momentin e aksidentit.

Se personi i tretë z. " " i dëmtuar në këtë aksident është kompensuar në emër të shkaktimit të demit nga ana e paditëses, vërtetohet në bazë të urdhër transferit të datës 03.09.2012.

Nuk është kontestuese qe personi i tret ka qen i dëmtuar pasi qe kjo vërtetohet me raporti i aksidentit me nr. " " i dt. 04.08.2012, se bashku me skicën e aksidentit.

Sa i përket të drejtës materiale gjykata u bazua në nenin 18.1 dhe 18.4 të Ligjit për Sigurim të Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia, pasi i padituri në momentin e aksidentit ka drejtuar automjetin e pa siguruar, ndërsa dëmin e shkaktuar e ka mbuluar " " , e cila ka të drejtën e regresit.

Gjykata, lidhur me shpenzimet procedurale, u bazua në nenin 452 të LPK-së (Ligjit të Procedurës Kontestimore), ku parashihet se pala e cila humb procesin gjyqësor tërësisht ka për detyrë qe palës kundërshtare gjyqfituse t'i shpërblej të gjitha shpenzimet gjyqësore

Me sa u tha me larte e ne baze të nenit 143 te LPK, u vendos si ne diapozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
C.nr 668/2015 Datë: 27.09.2017

GJYQTARI
Naim Mehulli

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi lejohet ankesa ne afat 15 ditor nga data e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet kësaj gjykate.